

# Kontratë

## Për shitblerjen e kuotave të shoqërisë "Koha Jonë"



Asambleja e ortakëve të shoqërisë "Koha Jonë" shpk, në mbledhjen e saj të sotme, datë 30 janar 1997, ka njohur largimin nga shoqëria të ortakut Aleksandër Frangaj dhe blerjen e të gjitha kuotave të tij nga ortakut Nikollë Lesi duke u bërë kështu pas përfundimit të formaliteteve zotërues i 100 % të kapitalit themelor të pasurisë.

Ortakut Nikollë Lesi zotërues i 60% të kapitalit të shoqërisë "Koha Jonë" shpk do të jetë në këtë kontratë me cilësinë e blerësit, ndërsa ortakut Aleksandër Frangaj, zotërues i 40 % të kapitalit të kësaj shoqërie në këtë kontratë do të jetë në cilësinë e shitësit.

Shitësi dhe blerësi bien dakort që me mirëkuptim, pa patur nevojën e ekspertëve, vlera e kuotave dhe pasurisë së shoqërisë që përfaqësojnë 40 % të saj të jetë 140 000 (njëqind e dyzet mijë) dollarë.

Shitësi Aleksandër Frangaj i shet shoqërisë "Koha Jonë", ortakut të mbetur Nikollë Lesi, të gjitha kuotat e tij dhe pjesën që i takon në pasurinë e kësaj shoqërie në vlerën 140 000 (njëqind e dyzet mijë) dollarë, blerësi Nikollë Lesi i blen shitësit Aleksandër Frangaj të gjitha kuotat e tij dhe pasurinë e shoqërisë që zotëron në këtë masë në vlerën 140 000 (njëqind e dyzet mijë) dollarë.

Shuma prej 140 000 (njëqind e dyzet mijë) dollarësh konsiderohet e shlyer në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Pas nënshkrimit të kontratës blerësi Nikollë Lesi dhe shitësi Aleksandër Frangaj nuk kanë asnjë detyrim ndaj njeri tjetrit. Shoqëria "Koha Jonë" me ortak të vetëm Nikollë Lesin mbart të gjitha detyrimet që ka kjo shoqëri ndaj të tretëve.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate ortakut i vetëm Nikollë Lesi bëhet zotërues i 100 % të kapitalit të shoqërisë "Koha Jonë".

**Shitësi**  
**Aleksandër Frangaj**

КOHА ЈОНЕ  
Ltd. Export-Import  
LEZHE

**Blerësi**  
**"Koha Jonë", ortakut i vetëm**  
**Nikollë Lesi**

Tiranë, 29 Korrik 1996

# Kontratë shitje

Lidhet sot me datë 29 (njetzenentë) Korrik 1996 (njëmijëenentëqindenedhjeteeqjashtë) në Tiranë mes këtyre palëve:

1-Nikollë Lesi me cilësinë e blerësit, banues në Tiranë, aktualisht bashkëpronar me 60 % të aksionëve të gazetës "Sport Ekspres", sipas vendimit të gjykatës së Tiranës, datë 22.08.1995 me numër vendimi 2814/2.

2-Aleksandër Frangaj me cilësinë e shitësit, banues në Tiranë, aktualisht bashkëpronar me 40 % të aksionëve të gazetës "Sport Ekspres", sipas vendimit të gjykatës së Tiranës, datë 22 .08.1995 me numër vendimi 2814/2.

Objekti: shitja e 40 % të aksionëve të gazetës "Sport Ekspres", e cila është njohur me vendim të gjykatës së Tiranës, datë 22.08.1995. Gazeta "Sport Ekspres" është filial i shoqërisë SHPK "Koha Jonë", ku bashkëpronarë janë Nikollë Lesi dhe Aleksandër Frangaj me raporte aksionesh 60% me 40 %.

Shuma e shitjes: 850000 (tetëqindpesëdhjetëmijë) lekë.

Kushtet:

1-Pas kësaj date Aleksandër Frangaj humbet pjesën e tij prej 40 (dyzet) për qind të aksionëve të gazetës "Sport Ekspres" dhe ortakut i deritanishëm Nikollë Lesi bëhet automatikisht pronar i vetëm me 100 (njeqindperqind) të gazetës "Sport Ekspres".

2-"Sport Ekspres" kalon me zyra me vehte dhe merr në pronësi këto objekte:

2/a. Dy kompjutera (Athens) vlera 200.000 (dyqindmijë) lekë

2/b. Një Tv kolor + Antenë parabolike " 35000 (tridhjetëpesëmijë) lekë

2/c. Dy tavolina + 1 Raft " 10000 (dhjetëmijë) lekë


Këto mallra janë brenda shumës prej 850.000 (tetëqindpesëdhjetëmijë).

Palët deklarojnë se likuidimet financiare janë bërë në rregull në momentin e lidhjes së kontratës.

Kjo kontratë pasi lexohet dhe gjendet konform vullnetit të lirë të dyve firmoset.

Shitësi  
Aleksandër Frangaj

Blerësi  
Nikollë Lesi



REPUBLIKA E SHQIPËRIKË  
DHOMA E NOTERIKË TIRANË

Nr. 4071 Rep.  
Nr. 787 Kol.

## V E R T E T I M

Sot me datën 14 Gusht 1996 (nëntëdhjet e gjashtë) u paraqitën personalisht palët si më lartë Nikolla Lesi dhe Aleksandër Frangaj, të dy meqenëse, me rastin të plotë juridike për të vepruar, me lotin njoftimet MF Nr. 138402 dhe MF Nr. 138935, të cilët deklaruan se se më sipër është bërë në hartë të vullnetit tyre të lirë dhe të plotë, jashtë kësaj syre, prandaj e nënshkruan këtë rregullim dhe në noterje e vërtetë sipas ligjit.